

Dr. Jahja Drançolli

RAGUZANËT NË TREPÇË DHE NË QYTETE PËRRETH GJATË SHEKUJVE XIV—XV

Sipas gërmimeve arkeologjike në rajonin e Mitrovicës së Titos së sotme, mund të konstatohet se në këtë trevë kanë ekzistuar disa lokalitete antike. Kështu, në Banjskë ka ekzistuar një stacion termal romak. Ndërkaq, me zbulimin e disa monumenteve epigrafike mund të supozojmë mundësia e ekzistimit të vendbanimit romak në këtë qytet, gjë që është vërtetuar edhe me rastin e zbulimit të nekropolit antik në periferi të qytetit.¹ Në periudhën mesjetare, Mitrovicën e Titos, sipas hartës së Faber Licinit, shëstuar në vitin 1560, e ndeshim me emrin Mitrouiza. Në dokumente raguziane të gjysmës së parë të shek. XV De Dimitrouic. Sipas Arnold Harffit, Mittrix. Ndërkaq, në hartën e Merkatorit e ndeshim të shënuar si Mitrouiza.² Me periudhën antike lidhet edhe statio Vicianum (Vuçiterna e sotme). Nga ky qytet janë të njohura disa monumente epigrafike, si dhe një kompleks i vogël arkitektonik (vila rustica).³ Meqë vendësit e kësaj ane dhe më vonë pushtuesit romakë dinin t'i shfrytëzonin burimet metalore dhe fakti se kjo trevë ishte shumë e pasur me këto burime, na bëjnë të kuptojmë se këtu u ngritën shumë vendbanime, që në antikitet.

Më vonë, në shek. IX, u ngrit për nevoja strategjike të pushtetit bizantin edhe Zveçani. Ndonëse kërkimet arkeologjike në këtë anë japin deri diku të dhëna të mjaftueshme, është vështirë të jepet ndonjë mendim i prerë për ekzistimin e Trepçës në periudhën antike. Trepça, pas burimeve mesjetare, zihet ngoje për herë të parë në vitin 1303. Në dokumentet mesjetare e ndeshim me emrin Trepça, Trepçe, Tripçe, Tripza, Trepza etj.⁴

¹ E. Çerškoviç, *Romakët në Kosovë dhe Municipiumi D. D. te Sočanica*, Prishtinë, 1973.

² G. Srivanić, *Najvažnije etape u razvoju toponomije jugoslavenskih zemalja na starim kartama, IC*, Beograd, 1971/XVIII, 119; P. Matković, *Putovanja po balkanskom poluostrvu za srednjega veka, RAD, JAZU, Zagreb*, 1878/XLII, 182; AHD. *Acta consilii Minoris* v. p. 47.

³ E. Çerškoviç, *Romakët në Kosovë*, 48—49.

⁴ *Zbornik K. Jirečeka I*, Beograd, 1959 267; në shumë vende, të librave *Reformationes* dhe *Acta Consilii Minoris*, të Arkivit Historik të Dubrovnikut (HAD).

Pas të dhënave që kemi, raguzanët i ndeshim në Trepçë për herë të parë në vitin 1313, përkatësisht më 7 prill të këtij viti ndeshim në këtë qytet bujarinë e njohur raguzan Marcus de Lucari. Është për t'u theksuar se M. de Lucari mbante lidhje aktive afariste me mbretërinë serbe, pra edhe me trojet e Kosovës, që atëbotë ishin në kuadër të kësaj mbretërie, gjë që dëshmohet nga të dhënat, të cilat tregojnë praninë e tij në këto anë gjatë viteve 1311, 1313, 1318, 1319, 1323 dhe 1324.⁵

Në gjysmën e parë të shek. XIV në Trepçë ndeshim edhe disa pjesëtarë të familjes së njohur bujare raguzane de Mençe. Ka të ngjarë se pjesëtari më i njohur i kësaj familjeje, Domagna f. Nicole Marci de Mençe (1313—1358), qëndroi një kohë të gjatë në Trepçë. Këtë mund ta dëshmojë fakti se komuna raguziane vendosi që për kripën e eksportuar raguziane nga ana e qytetarëve të Trepçës të obligoheshin ta bartin plumbin e Domagna de Mançes nga Trepça në Raguzë.⁶ Në testamentin e vet të hartuar në vitin 1358, Domagna de Mençe bën fjalë, ndër të tjera, edhe për llogaritë e tij doganore me Marinus de Goçen dhe për doganat e Trepçës.⁷

I vëllai i Domagnes, Marcus, përmendet shpesh në shërbime të ndryshme komunale. Gjatë viteve 1329 dhe 1331 ishte anëtar i Senatit Raguzan. Edhe Marcus, si dhe vëllai i tij, qëndroi një kohë në Serbi. Në mars të vitit 1336 ai nxori përfitim nga venedikasi Nicoletto Quirino 260 perperë. Ndërkaq, më 15 mars 1344, ky mori një letër në Trepçë. Nga përmbajtja e kësaj letre mësojmë se Marcus N. De Mençe kishte huazuar 250 perperë nga kushëriri Lampre L. de Mançe.⁸ Kjo letër iu paraqit, përmes delegatëve Milaus dhe Milcus Optuzar dhe gjykatësit të gjykatës, Symone de Benessa, më 31 mars po të këtij viti edhe Këshillit Raguzan.⁹

Në gjysmën e parë të shek. XIV një rol me rëndësi në zhvillimin e tregtisë së Trepçës kishin edhe venedikasin, splitasin, sidomos kotorrasit. Mirëpo, xeheroret e pasura të Trepçës bënë që ndërmjet tregtarëve të përmendur, për shkak të rivalitetit, të lindnin konflikte dhe mosmarrëveshje të ndryshme, si, bie fjala, në vitin 1333, me rastin e një pagese për plumb të Trepçës, bien në mosmarrëveshje dy kotorras, Triphon Carbous dhe Georgium Cerneli. Si dëshmitarë u paraqitën po ashtu dy kotorras, Pascalem Bartholi et Base de Salue.¹⁰

Dijetari i mirënjohur, K. Jireček, duke bërë kërkime arkivore në Arkivin Historik të Dubrovnikut, në kaptinat e librave *Diversa Cancellariae*, që tani gjenden në librin *Distributiones Tes-*

⁵ HAD, *Diversa Cancellariae V*, f. 46; I. Man ken, *Dubrovački partocijat*, Beograd, 1960, 295—296; M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, Beograd, 1978, 400.

⁶ *Monumenta Ragusina V*, 314.

⁷ T. Smičiklas, *Codex diplomaticus*, XII, 659.

⁸ *Monumenta Ragusina I* (1306—1347), Zagrebiae 1879, 196.

⁹ *Monumenta Ragusina I*, 197.

¹⁰ A. Mayer, *Liber Notariorum Catarensiu I*, Zagreb, 1951, nr. 1088, fq. 366—367, 561.

tamentorum (1349—1357), ndeshi një të dhënë interesante për zhvillimin e historikut të xehetarisë së Trepçës. Nga kjo e dhënë mësojmë se notari Solfredo regjistroi në libër letrën e marrë nga Trepça »A. D. MCCCXL (duhet 1349) di XXIII març«, nga e cila shihet se bujari venedikas ser Giannius Giorgi i kishte shitur plumbin e Trepçës Micho e Buchia-s, bujar raguzan me origjinë kotorrage. Mirëpo, shitblerjen e pengoi princi serb, i cili, i urdhëruar nga perandori Dushan, pengonte eksportimin e plumbit të Trepçës, meqë plumbi i Trepçës ishte destinuar për ta mbuluar çatinë e Manastirit të Shën Arkangjelit në Prizren. Nga deklarata e ser Gianninus Georgit mësojmë se fjala ishte për një sasi plumbi që kapte vlerën 10.000 perperë. Në letrën e vet ai thekson se kishte shtëpi në Trepçë dhe si dëshmitarë kishte vënë dy sasë, disa raguzanë dhe kotorras. Nga kjo e dhënë del se atëbotë plumbi i Trepçës është shfrytëzuar me të madhe.¹¹

Është ëpër t'u theksuar se në Trepçë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIV ndeshim në dokumente të kohës një numër shumë të vogël tregtarësh dhe bujarësh raguzanë. Nëse merret parasysh fakti se Raguzë fitoi në vitin 1358 statusin e komunës së lirë, si dhe mungesën e xeheve, në radhë të parë të argjendit, në Evropë, ku prej mesit të shek. XIV prodhimi xehetar bie dukshëm, kurse raguzanët e shfrytëzuan me shkathtësi të madhe këtë zbrazësirë, atëherë vetvetiu na del përfundimi se edhe gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV në Trepçë vepronin, përveç sasëve xehetarë edhe tregtarë raguzanë. Ky konstatim mbështetet edhe në faktin që dokumentet e kësaj kohe dëshmojnë për praninë e raguzanëve në gjysmën e dytë të shek. XIV në Novobërdë, Prizren dhe në disa vende të tjera të Kosovës.

Pas rënies së shtetit serb, Trepça hyri në kuadrin e zotërimeve të Brankoviqëve. Tani ajo paraqiste pa dyshim qendrën më të madhe të këtyre zotërimeve. Vuk Brankoviqi, ndryshe nga fqinji i tij princ Lazari, privilegjoi shumë herët tregtarët raguzanë. Nga disa të dhëna vërehet se Vuk Brankoviqi mbante lidhje diplomatike dhe ekonomike me Raguzën. Në këtë drejtim në vitin 1395 ai la nga Trepça në besim komunës raguzane 1880 libra argjend me vlerë afro 15.000 dukatë.¹²

¹¹ K. Jireček, *Spomenici srpski, Spomenik SKA, XI*, Beograd, 1982, 28, — »E Ualço (duhet Balço), 10 conte del mercado, si venne la, digando: Ci non daro ad alcuna persona a toccar lo dicto plombo, perche misser l'imperadored de Rascia si m'a mandato, digando per l lettera comandando, che quello plombo, chello... de Santo Arcangelo a trouto sotto terra, recomandando li to, chello la dia a persona del mondo, sia di chi uol, saluo al dicto igumen per courir la soa clesia d'Arcangelo, sotto pena della vita, e ffe leger la dicta lettera in plaçia in presençia de tucti« Gianninus mbrohej« »Conte, io non se debitor ni a re ni a imperador ni a persona di Sclauonia: non mi tuor lo mio per forza« Princi serb i përgjigjej: »Tu aldissi ço, chel mio signor me comandi, non olso fare altro«. Pastaj Gianninus premtan: »Buona pleçaria, vuos Tedeschi o Slau i Latini, chi te plase se misser l'imperadore uora questo plombo, quanto e questo et ancora plu; io uo far ogni dampno e spese et intersse, che per ço posse auere per questo plombo«.

¹² K. Jireček, *Spomenici srpski*, 40.44; M. Dinić *Srpske zemlje u srednjem veku*, 401.

Edhe pse Trepça ishte vendbanim xehetar dhe qendër e madhe ekonomike mesjetare, prapëseprapë, për shkak të mungesës së dokumenteve të kohës, është vështirë të ndiqet shtimi i shtresës tregtare vendëse. Gjatë gjithë rrjedhës së mesjetës, të paktën nga burimet e ruajtura, në këtë qendër xehetare, si për nga numri, ashtu edhe për nga afarizmi, shquhen tregtarët e huaj, në radhë të parë raguzanët, ndërsa tregtarët vendës shfaqeshin sporadikisht, si, bie fjala, në vitin 1429 në Trepçë zihen ngoje tregtarët Radishin dhe Marko Pribilovi, si dhe pjesëtarët e familjeve Golemade dhe Rodopi.¹³ Tregtarët e Trepçës shumë rrallë, madje me shuma të vogla, hynin borxh te kreditorët raguzianë.¹⁴

Në Trepçë, si dhe në tërë zotërimet e Brankoviçëve, despot Stefanin nuk kishte kurrfarë ndikimi, kështu që Mara Brankoviç së bashku me fëmijët, lëshoi tërësisht e pavarur disa dokumente dedikuar tregtarëve raguzanë, sipas të cilave raguzanët morën me qira disa tregje të saj, si dhe bëri përpjekje për zhvillimin e marrëdhënieve intensive me Raguzën. Në këtë drejtim duhet të zihen ngoje dokumentet mbi tregtinë të lidhura më 5 dhe 29 dhjetor 1405 në Vuçiternë.¹⁵

Edhe pse qeveria raguzane i udhëzonte tregtarët e vet se mosmarrëveshjet me njërin nga dy sunduesit e trojeve të Kosovës nuk duhej ta pengonin zhvillimin e tregtisë me qytetet e sunduesit tjetër, kjo gjë nuk zbatohet siç ishte parashikuar. Pati raste kur tregtarët raguzanë u penguan të shkonin në zotërimet e një sunduesi. Ndërkaq, po në këtë kohë marrëdhëniet ishin të acaruar edhe në zotërimet e sunduesit tjetër, gjë që dëshmohet nga një urdhër i Këshillit të Rogatëve i shkurtit të vitit 1411 lidhur me pengimin e tregtarëve të vet në zotërimet e zonjës Marë, pra edhe në Trepçë.¹⁶ Po kjo gjë u përsërit edhe në vitin 1417, kur qeveria kishte rënë në konflikt me despot Stefanin dhe atëherë ajo shqyrtoi çështjen e pengimit të vajtjes së tregtarëve të vet në Serbi.¹⁷

Mosmarrëveshjet e përmendura ishin të ditës dhe nuk ndikuan shumë në rrjedhën e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Raguzës dhe Brankoviçëve. Kështu, duke marrë parasysh nevojën që kishte Evropa për xehe, numri i raguzanëve në Trepçë gjatë çerekut të parë të shek. IX rritej dukshëm. Gjatë kësaj kohe tregtarët dhe bujarët raguzanë eksportonin nga Trepça sasi të mëdha

¹³ HAD, *Acta Consilii Minoris IV*, fq. 280; I. Ruvarac, *Godišnjica Nikole Čupića, XX*, Beograd, 1900, 249 (Goljemović Đura); *Srpske zemlje u srednjem veku*, 403.

¹⁴ HAD, *Debia Notariae III*, fq. 180; I. Voje, *Kreditna trgovina u srednjovekovnom Dubrovniku*, Sarajevo, 1976, 218, 249, 250, 256, 315.

¹⁵ HAD, *Acta et diplomata nr. 1029*; Lj. Stojanović, *Stare Srpske povelje i pisma, I—1*, Beograd — S. Karlovci, 1929, 151—154.

¹⁶ HAD, *Reformationes XXXIII*, fq. 290^v (4. II. 1411) — »de vetando nostris mercatoribus et retinendo quod non vadant cum mercibus in contratas domine Mare usque ad adventum nostri cursoris predicti (missi in Tripze)...«; Lj. Stojanović, *Povelja i pisma, I—1*, 151—161.

¹⁷ M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, 168 — »in Sclauonia, hoc est in contrata despot solummode et suis tenuitis omnibus«.

plumbi dhe argjendi. Në punë të këtilla gjatë kësaj kohe ndeshim shumë raguzanë, Bie fjala, në vitin 1401 në Trepçë ndeshim bujarin raguzan Dimcho de Bobolio, në vitin 1409 Francho de Basiglo, Andrea Polo de Sorgo dhe Domingo de Bobalio;¹⁸ në vitin 1410 Andrea f. di Pautho Pizurcho, Stane Tuerdizdoglich, Mechoye Progonouich dhe Radich Stoichouich,¹⁹ në vitin 1412 Marino de Nale, Nichxa de Tuertcho dhe Ziuchi Rugich,²⁰ në vitin 1414 Maroe de Nale, Pael Martinouch, Serdi Radoslaglich, Bogdan Milienouich dhe Bigissa Radmilouich,²¹ në vitin 1421 Giurach Radieouich, Radossau Zuichouich. Desin Nicolich dhe Bisiccho Milienouich,²² në vitin 1426 Barissau Dobretiuich dhe Brancho Bogoeuich me fëmijët e vet.²³

Bujarët dhe tregtarët raguzanë, duke i shfrytëzuar pasuritë e mëdha të Trepçës dhe duke qenë të aftë t'i nxirrnin ato në tregje të ndryshme evropiane, nxirrnin fitime të mëdha. Në Trepçë ka pasur madje raguzanë që zotëronin shtëpi, puse të xeheroreve dhe pasuri të tjera të paluajtshme, gjë që dëshmohet nga testamentet e bujarëve dhe të tregtarëve raguzanë të vdekur në Trepçë. Nga këto veçohet sidomos testamenti i Junii J. de Sorgos, i vdekur në Trepçë. Testamenti është përpiluar në Trepçë më 9. IX. 1409. Aty nënvizohet se zonja Marë i ka borxh 109 libra argjendi, 1 unazë dhe 4 akse. Më tutje theksohet se ka të holla serbe me vlerë 15 libra. »Kam pastaj — thekson Sorgo — në sheshin e Trepçës një shtëpi të vjetër dhe një dhomë me mur që më ka kushtuar 25 libra«. Njërin gjysmë të shtëpisë ua lë bijve të vet, ndërsa tjetrën birit të vet jolegjitim Gjergjit në Trepçë. Edhe Gjergji, edhe bijtë legalë e kanë për detyrë që për shtëpinë që zotërojnë t'i japin çdo vit kishës së Shën Mërisë të Trepçës nga 6 unza, banuan në atë shtëpi ose jo ose po t'ia japin ndokujt me qira. Nga ajo libër (d.m.th. 12 unza), kishës i takojnë 3 unza, plebanit 3, ndërsa kapelanëve të tjerë 6 unza. Bijtë do të jenë të detyruar t'ia japin atë libër kishës derisa të ekzistojë shtëpia. Nëse digjet ose e shkatërron ushtria, bijtë nuk kanë më për detyrë të japin gjë. Një rëndësi të jashtëzakonshme kanë pastaj dispozitat që kanë të bëjnë me atë djalë jolegjitim, jo për vetë atë, por për shkak të xehetarisë. »Nëse biri im Gjergji nuk do të kishte asgjë nga xehja (xehet) në pjesët e veta që i ka shfrytëzuar me ndihmën time dhe do të donte të vinte te vëllezërit në Raguzë për të treguar, dua t'i jepen nga pjesa ime dyqind perperë«. Nëse do të ketë xehe dhe do të mbesë në Serbi, nuk do t'i jepet asgjë. Më tutje thuhet se ka çerekun e një qerreje (carro) me vojvodën Pashait. Ka edhe pusin e quajtur Slauomir dhe gjashtë pjesë me xehe, nga të cilat Mathia de Ribičit t'i jepet një e treta nga dy »pjesë«. Më tutje në testament përmendet pusi i quajtur Slauma me xehe, në të cilën

¹⁸ HAD, *Lettere et commissione Levantis IV*, 154.

¹⁹ HAD, *Lettere et commissione Levantis V*, fq. 35.

²⁰ HAD, *Lettere et commissione Levantis VII*, fq. 30.

²¹ HAD, *Lettere et commissione Levantis VII*, fq. 98—98v.

²² HAD, *Lettere et commissione Levantis VIII*, fq. 18, 35, 37v.

²³ HAD, *Lettere et commissione Levantis IX*, fq. 126v.

ka tetë pjesë. Përmend edhe puse të tjera të veta dhe amanetin që t'i ngallmohet kishës së Shën Mërisë në Trepçë një karrocë nga dy libra argjend dhe të paguhet punimi i saj.²⁴

Testamente me karakter të këtillë përpiluan edhe një sërë bujarësh dhe tregtarësh raguzanë, të cilët vepruan dhe mbaruan jetën në Trepçë. Por, për ndriçimin e aspekteve të ndryshme të zhvillimit ekonomik, sidomos të zhvillimit të xehetarisë në Trepçë dhe rrethinë, rëndësi të madhe kanë këto testamente: testamenti i Rados Globoeuich, i përpiluar në vitin 1427 në Trepçë,²⁵ i Petcho Radoycauich dhe i Zupyana Marcus de Dobrosseuich, të përpiluar në vitin 1439 në Trepçë.²⁶

Është për t'u theksuar se që nga fillimi i shekullit XV, sidomos nga viti 1407, numri i bujarëve, sidomos i qytetarëve raguzanë në Trepçë rritej dukshëm. Madje, kolonia raguzane në Trepçë gjatë njëzetvjetshit të parë të shekullit XV, ishte më e madhe se ajo e Novobërdës dhe e Prishtinës. Këtë konstatim e ilustron më së miri kjo tabelë statistikore:

Viti	Bujarë	Qytetarë	Konteste
1	2	3	4
1407	10	20	7
1408	10	20	8
1409	20	128	49
1410	17	119	47
1411	16	239	87
1412	12	261	66
1413	6	128	51
1414	7	104	30
1415	2	69	22
1416	2	40	18
1417	2	39	15
1418	2	43	9
1419	2	58	17
1420	1	73	22
1421	1	76	19
1422	—	97	29
1423	2	158	47
1424	4	134	39
1425	2	110	34
1426	—	110	31
1427	2	66	14
1428	—	106	30
1429	—	53	18
1430	—	22	6
1431	—	31	9
1432	—	22	3
1433	—	16	5

²⁴ HAD, *Testamenta Notaria IX*, fq. 130; M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, fq. 405—406.

²⁵ HAD, *Testamenta Notariae XI*, fq. 176—176^v (më 3. VII. 1428 — 5. I. 1427).

²⁶ HAD, *Testamenta Notariae XIII*, fq. 57—57^v, 59—59^v (më 27. XII. 1439 — 13. X. 1439 dhe 6. I. 1440 — ... 1439).

1	2	3	4
1434	1	28	14
1435	1	52	18
1436	—	45	18
1437	—	28	7
1438	—	49	24
1439	2	47	14
1440	—	16	3
1441	—	8	1
1442	—	30	7
1443	—	—	—
1444	—	6	1
1445	—	22	7
1446	—	9	3
1447	1	12	3
1448	—	—	—
1449	2	35	10
1450	4	30	9
1451	1	8	2
1452	—	10	1
1453	—	12	4
1454	—	5	1

Nga tabela e sipërme vërehet se lëkundjet e kolonistëve raguzanë nga viti në vit ishin më të mëdha. Lëkundjet e këtilla ishin rrjedhim i fushave të herëpashershme osmane, si dhe i mosmarrëveshjeve me sunduesit lokalë dhe despotin. Megjithatë, Trepça na del prapëseprapë si koloni e madhe. Gjatë viteve 1415—1455, numerikisht, kolonia raguzane në Trepçë, vinte pas Novobërdës dhe Prishtinës. Ndërkaq, gjatë viteve 1407—1414, Trepça ishte kolonia më e madhe raguzane në Kosovë. Madje, gjatë viteve 1411—1412, numri i kolonistëve raguzanë arrin në 235, përkatësisht 254.

Pjesa dërmuese e numrit të raguzanëve, të cilët vepronin në Trepçë, na del nga kontestet e kolonistëve mes tyre, pastaj me osmanët dhe me sunduesit lokalë, si dhe me vendësit. Është e natyrshme se të gjitha raguzanët, të cilët kanë vepruar në Trepçë, nuk kanë mundur të kenë konteste, po ashtu ka pasur edhe të atillë, të cilët kanë ardhur në këtë qytet për një kohë të shkurtër ose ishin në kalim, si dhe një numër i konsiderueshëm i tyre vepronin njëkohësisht në disa qytete të afërme. Duke u nisur nga këto të dhëna mund të konstatohet pa vështirësi se numri i raguzanëve, të cilët vepronin në Trepçë ka qenë pa dyshim më i madh se si që shihet në tabelën e sipërme.

Ndryshe nga kolonitë të tjera raguzane në Kosovë, në Trepçë na del numri më i vogël i bujarëve raguzanë, sidomos pas vitit 1415 dhe më tej gjatë tërë gjysmës së parë të shekullit XV. Konstatimi ynë për këtë dukuri mbështetet në faktin që interesimi i bujarëve raguzanë ishte i përqëndruar më tepër në Novobërdë dhe Prishtinë, gjë që shihet nga kjo e dhënë: derisa gjatë viteve 1445—1454 në Novobërdë hasim në tridhjetë e nëntë raguzanë, në Prishtinë, gjatë viteve 1445—1453, njëzet e tre, dhe po në këto vite, përkatësisht gjatë viteve 1445—1454, në Trepçë ka pasur ve-

tëm shtatë bujarë. Numri i tyre gjatë viteve 1415—1444 në krahasim me Novobërdën dhe Prishtinën, është edhe më i vogël, gjithsej njëzet e katër.

Pasuritë natyrore të Trepçës ndikuan që të vepronin këtu një kohë ca më të gjatë disa familje bujare, ku dhe u përqëndrua aktiviteti i tyre i tërësishëm. Nga familjet bujare raguzane, në Trepçë hasim më shpesh pjesëtarë të familjes Sorgo (Andrea, Junius, Junii Iuani, Jacobus, Jacomo, Matcho, Marinus, Nicola). Nga këta lidhje më intensive me Trepçën mbante Junius de Sorgo (nga fundi i shekullit XIV dhe në fillim të shekullit XV). Përveç pjesëtarëve të kësaj familjeje, në Trepçë hasim edhe pjesëtarë të familjeve bujare: De Basiglio (Francho), De Benessa, De Bobalio (Dmincho, Dominich, Junius), De Bona (Simon), De Calich (Junius Dobre), De Crose (Marcus Ju.), De Cabago (Luxe), De Gondola (Benedetto, Jacobo), De Gozze (Alousius, Marinus, Palcho, Paulus), De Gradi (Marin), De Geörgio (Blasio, Nicola), De Luchari (Marcus), De Mençe (Domagna, f. Nicole Marci, Lampre L.), De Prodanello, (Nicole), De Saracha (Marinus), De Volço (Andreas. Andruschus), De Zamagna (Martol).²⁷

Ndryshe nga bujaria, qytetarët raguzanë vinin shumë më shpesh në këtë qytet, madje disa prej tyre vepruan këtu gati gjatë tërë jetës së vet, si, bie fjala, Zuichus Guirchouich dhe Jaxa Braichouich, vepruan në Trepçë më tepër se tridhjetë vjet. Një kohë të gjatë vepruan në Trepçë edhe Simon de Duye, Marinus de Nale, Bogdan Lipchovich, Sergius Peçinich, Marchus Tintina, Zuietchus Vlacanovich, etj. Po ashtu shpesh zihen ngoje edhe këta tregtarë raguzanë:

Ancho Dobrosseuich
Bogissa Radmillovich
Maroe Ptizich
Maroe Giurchovich
Jacobi Braichi Tintina
Luxa Radmilovich
Jacobus de Benevenuta
Jachas Tintinich
Marchus Braichovich
Nixam Milsich
Priuinaz Jiloieuich
Radisin Utisinouch

Përveç bujarëve dhe qytetarëve raguzanë, në konteste të ndryshme të qytetarëve raguzanë ndërmjet tyre në Trepçë dhe me vendësit, ndeshim edhe tregtarë që vinin në Trepçë nga qytete të ndryshme, si, bie fjala, Spliti, Venediku, Kotorri, Shkodra, Tivari

²⁷ HAD, Në shumë vende të librave (I—XIII) të Këshillit të Vogël, *Reformationes* (XXXII—XXXIV), *Lettere et commissioni Levantis* (IV—XIV); *Monumenta Ragusina I*; *Testamenta Notariae IX*, fq. 130; K. Jireček, *Spomenici srpski*, në shumë vende.

etj. Në këto konteste hasim edhe disa qytetarë shqiptarë, të cilët ushtronin profesione të ndryshme. Në konteste gjyqësore më shpesh zihen ngoje këta: Stepchum Progonovich (viti 1408), Zuitchi Ginovich (1409, 1415, 1417, 1425), Michoy Gonovich (1409), Nicoliça Giergas (1412, 1413, 1422, 1423), Michelius Albanesem (1417), Michael Progonovich (1422, 1423, 1424, 1428), Marin Ginovich (1423), Vlatchi Gonchovich (1425). Në konteste të kolonistëve raguzanë, në Trepçë ndeshim edhe një numër të konsideruar skllëvërisht, të cilët ishin pronë e bujarëve ose e qytetarëve raguzanë. Dukuri që flet se disa raguzanë në koloni sillnin më vete edhe skllëvërit e tyre. Po ashtu, nuk ishin të rralla rastet kur tregtarët raguzanë vinin në Trepçë me ortakët e tyre (kompanjonët). Mirëpo, bashkëpunëtorë të tillë tregtarë raguzanë gjenin edhe në koloni të tyre, pra edhe në Trepçë.²⁸

Derisa bujarët raguzanë nuk i hasim çdo vit në Trepçë, qytetarët raguzanë në anën tjetër vepronin këtu pandërprerë dhe numri i tyre në këtë qytet ishte i përfillshëm, madje gjatë viteve 1409—1414 numri i tyre ishte gjithnjë mbi njëqind. Mirëpo, në distancë të viteve të përmendura, përkatësisht gjatë viteve 1411—1412, numri i qytetarëve raguzanë në Trepçë arrin në 235, përkatësisht 254. Po ashtu, kolonia raguzane në Trepçë ndërkohë e kalon shifrën njëqind edhe gjatë viteve 1423—1426.

Mosmarrëveshjet dhe kontestet ndërmjet qytetarëve raguzanë në Trepçë i zgjidhte konsulli raguzan. Ndryshe nga Prizreni, Novobërda dhe Prishtina, ku që nga shekulli XIV vepronin konsujtë e përhershëm raguzanë, në Trepçë konsujt raguzanë emëroheshin sipas rasteve të paraqitura. Ndërkaq, në këtë post zakonisht vinin qytetarët e Raguzës, të cilët vepronin në Trepçë. Në zgjidhje të çështjeve të përmendura konsullin e shoqëronin edhe dy gjykatës raguzanë, të cilët i emëronte Këshilli i Vogël (Consilium Minoris) i Raguzës. Nga të dhënat që kemi, konsulli i parë raguzan për Trepçë u emërua me 21 maj 1403. Si konsull i parë emërohet bujari raguzan Dominichus de Menze.²⁹

Ndryshe nga Prishtina dhe Novobërda, ku pjesa dërmuese e konsujve, e ambasadorëve dhe e gjykatësve i takonin shtresës së bujarisë raguzane, në Trepçë në poste të tilla vinin kryesisht pjesëtarët e shtresës qytetare raguzane. Kjo dukuri ishte e pranishme sidomos gjatë viteve 1421—1454. Mirëpo, gjatë viteve 1403—1419, numri i bujarëve raguzanë në poste të përmendura ishte i dukshëm, prej gjithsej 1105 vendeve, përfaqësuesit e bujarisë raguzane zinin 667 vende. Ndërkaq, përfaqësuesit e shtresave qytetare 438 vende. Paraqitja më masive e bujarisë raguzane në poste të tilla vërehet sidomos gjatë viteve 1407—1414, gjithsej 644 vende. Po në këtë kohë, numri i të emëruarve në poste të këtilla nga shtresa qytetare, ishte i përgjysmuar (345).

²⁸ Në shumë vende të librave të Arkivit Historik të Dubrovnikut, *Acta Consilii Minoris* (librat I—XIII); *Reformationes* (librat XXXII, XXXIII dhe XXXIV).

²⁹ HAD, *Reformationes XXXII*, fq. 39^v (më 21. V. 1403).

Është për t'u theksuar se prej vitit 1407 (6 konsuj) e deri në vitin 1454 (përveç gjatë viteve 1443 dhe 1448) në Trepçë ndeshim për çdo vit nga disa konsuj, si, bie fjala, në vitin 1408 (7 konsuj) 1409 (43 konsuj), 1410 (45 konsuj), 1411 (86), 1412 (64), 1413 (51), 1414 (29), 1415 (20), 1416 (13), 1417 (12), 1418 (9), 1419 (17), 1420 (22), 1421 (19), 1422 (24), 1423 (45), 1424 (37), 1425 (34), 1426 (28), 1427 (14), 1428 (29), 1429 (18), 1430 (6), 1421 (8), 1432 (2), 1433 (5), 1434 (14), 1435 (18), 1436 (18), 1437 (7), 1438 (24), 1439 (14), 1440—1454 (52 konsuj).³⁰

Qytetarët raguzanë në Trepçë ushtronin edhe detyrën e le-vërdishme të doganierëve. Në saje të dokumenteve arkivore nga zyra të ndryshme raguzane, disa doganierë i njohim edhe me emra. Në vitin 110 në doganën e Trepçës hasim si doganierë Jonasin Bogissa Radmilouich dhe ortakët e tij Nouach Machiedoll, Maroe Alexich dhe Dikollë Gjergji. Në vjeshtën e vitit 1411 zonja Marë dhe kryezoti Gjuraraj, zotërues të Trepçës, i kishin dërguar komunës së Raguzës »pas Radomanit, pas Trepçasit«, fletëshkarkim për Maroje Neleshkoviçin. Në nëntor të po këtaj viti Mara dhe Gjuraraji njoftuan qeverinë raguzane se doganën e Trepçës dhe të Prishtinës i mbante Bogissa Radmilouich dhe se ai i kishte plotësuar të gjitha detyrimet.³¹ Ndërkaq, në fund të vitit 1412, të gjitha detyrimet ndaj doganës i kishte shlyer edhe qytetari raguzan Maroje Nedelkoviç. Në këtë vit hasim si doganierë në Trepçë edhe Jaxa de Benegrada dhe Nichola de Suezda.³²

Ka pasur raste kur tregtarët raguzanë ankoheshin kolektivisht në qeverinë raguzane për keqpërdorime që bënin doganierët e Trepçës, si, bie fjala, ankesat kundër doganierit Jaxa de Banegrada. Po ashtu, pati ankesa edhe për doganierët Bogdan Mile-nouich dhe Bogissa Radmilouich, të cilët vunë një sërë rishish që ngadalësonin dhe pengonin tregtinë në këtë qytet dhe më gjerë.³³

Në shtator të vitit 1414 Gjuraraj Brankoviçi u ripohoi në Vuçiternë organeve të pushtetit raguzan se Bogdan Milenouich »mbante tek unë doganën dhe punishten e prerjes së të hollave për një vit«. Edhe më vonë doganierë të Trepçës dhe qytetarë raguzanë binin në mosmarrëveshje me organet raguzane. Më 1421 hasim si doganierë në Trepçë raguzanët Stipchum Turdisalich, Jaxa dhe Anthoie Braichouich.³⁴

³⁰ Shënime të hollësishtme për numrin e saktë të konsullatave raguziane në Trepçë dhe më gjerë hasim në shumë vende të librave të Arkivit Historik të Dubrovnikut, në serialin *Reformationes* dhe *Acta Consilii Minoris*.

³¹ K. Jireček, *Spomenici srpski*, 60; Lj. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma I—1*, fq. 161—162.

³² HAD, *Lettere et commissione Levantis VII*, fq. 62v (14. III. 1412).

³³ HAD, *Lettere et commissione Levantis VII*, 98v — »Në shtator të vitit 1414 Gjuraraj Brankoviçi kishte urdhëruar që monedha e despotit të qarkullonte lirisht në zotërimet e tij — li denari del signor despoth — per che il signor Zorzi vuol che coram per tuto il sua paese et che nesun non li olsi refutar«.

³⁴ HAD, *Lamenta de foris III*, fq. 34, 36; Lj. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma I—1*, 154—167; M. Dinić, *Srpske zemlje u srednjem veku*, fq. 405.

Gjatë gjysmës së parë të shek. XV tregtarët raguzanë veprojnë me të madhe në Trepçë, zinin pozita udhëheqëse në tregtinë e qytetit dhe të rrethinës. Mirëpo, gjatë marrëdhënieve afariste ata godiste shpesh konkurrenca e bashkëqytetarëve të vet, kështu që kjo dukuri ishte dhe burim themelor i lindjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet vetë qytetarëve raguzanë e ndërmjet tyre dhe vendësve.

Të dhëna të para për këtë dukuri në koloninë e Trepçës hasim në dhjetëvjetshin e parë të shek. XV, përkatësisht nga viti 1410. Në këtë vit argjendari Mihai, në prani të raguzanëve Dimcho de Bobalio, Andrea de Goze dhe Nichola de Prodanelo, ia ktheu borxhin prej 50 perperësh Brajko Bogojeviçit dhe fëmijëve të tij. Kjo e dhënë ruhet në dokumentin e shkruar me alfabetin cirilik dhe mban datën 29. XII. 1411. Këtë të dhënë noteri raguzan e regjistroi në regjistrin e dytë të serialit *Diversa Cancellariae* dhe mban datën 19. I. dhe 29. VII. 1411. Përkitazi me këtë princi Clemente de Bodaca dhe gjykatësit raguzanë Andrea de Sorgo dhe Johanne de Volcio i shkruajnë më 19 gusht D. Chuchiulos në Trepçë, me ç'rast ia bashkangjiten letrës edhe dokumentin e sipërpërmendur të shkruar me alfabetin cirilik. Ndërkaq, qytetarët raguzanë, në emër të të cilëve ishte adresuar letra u përgjigjën më 24 shtator nga Trepça dhe pohojnë se ishin dëshmitarë për çështjen e përmendur dhe gjithë kjo u regjistrua në regjistër më 30 tetor.³⁵

Qeveria raguziane ndiqte me vigjilencë të madhe të gjitha kontestet e qytetarëve të vet në Trepçë dhe më gjerësisht, po ashtu zotohej për zgjidhjen e tyre, gjë që shihet nga e dhëna e sipërme, si dhe nga rasti i 27. XII. 1410, kur bujari raguzan Nicole Junii de Sorgo, së bashku me njëfarë Bogdan Lipchouich, hyri me dhunë në shtëpinë e Juan Charuçit, të cilit, ndër të tjera, ia plaçkitën edhe tërë dyqanin. Lidhur me këtë i plaçkituri Juan Charuç e lajmëroi më 16. I. 1411 princin dhe gjykatën raguzane. Në ankesën e vet Juani zë ngoje edhe dëshmitarët Andreas Ziue de Vulço, Bostticus Dragosseuich, Obrad, Zeuetcho dhe Tudro. Për zgjidhjen e këtij kontesti princi raguzan angazhoi tre bujarë, Nichola de Prodanello, Andreas de Volço dhe Dominichus A. Mençe.³⁶

Disa vjet më pas, përkatësisht më 23. XII. 1420, Stipchum Turdisalich ngre padi kundër bashkëqytetarit Maroe Giurchouich, i cili kishte hyrë me dhunë në shtëpinë e tij në Trepçë dhe kishte plaçkitur disa orendi argjendi. Maroje bëri plaçkën me bashkëpjesëmarrës të vet dhe ai kishte lidhje farefisnore me princin e vendit. Arsyen e plaçkës e vërtetuan tetë dëshmitarë.³⁷ Kontest identik ndërmjet qytetarëve raguzanë në Trepçë ndeshim edhe në shtator të vitit 1422. Në këtë vit, pas plaçkitjes së dyqanit të Braicho Bogovitch, ky njoftoi princin dhe gjykatën raguzane.³⁸

³⁵ K. Jireček, *Spomenici srpski*, fq. 56.

³⁶ HAD, *Acta et diplomata IVC*, fq. 12; K. Jireček, *Spomenici srpski*, fq. 56–57, dokumenti është shkruar në gjuhën latine dhe në sllavishten e vjetër.

³⁷ HAD, *Lamenta de foris IV*, fq. 274.

³⁸ HAD, *Acta et diplomata IV c*, fq. 19.

Numri i mosmarrëveshjeve dhe i kontesteve të qytetarëve raguzanë ndërmjet dhe me vendësit mori përmasa të mëdha si-domos në vitet tridhjetë dhe në dhjetëvjetshin e ardhshëm. Numri më i madh i kontesteve të qytetarëve raguzianë u paraqit në vitet 1411 (86 konteste), 1412 (64), 1413 (51) dhe 1423 (45). Në këtë pikëpamje, gjatë viteve të përmendura gjykatësit raguzanë që vepronin në Trepçë, madje edhe gjykatësit që vepronin në Raguzë dhe princi raguzan, bënin përpjekje të mëdha për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve të ndryshme.

Pasi ndiqet Vuk Brankoviçi, nga fundi i shekullit XIV, osmanët fusin në duart e veta fortifikatat më të rëndësishme ushtarake të zotërimeve të tij. Pushteti osman ndihej edhe në vende të tjera. Pushteti dualist serbo-osman ndikonte në zhvillimin ekonomik të Trepçës. Osmanët kontrollonin prodhimin xehetar, po ashtu disa pjesë të xeheroreve gjendeshin në duart e tyre. Gjatë kohës së pushtetit serbo-osman, ka të ngjarë se në Trepçë ka vepruar një punishte osmane e prerjes së të hollave. Për t'i realizuar interesat vetjake, përfaqësuesit osmanë tentonin të pengonin eksportimin e argjendit, por tregtarët raguzanë nuk respektonin përherë këtë ndalesë. Megjithatë, ndalimi i eksportimit të argjendit ka qenë vendimtar për këtë degë të ekonomisë dhe kështu fillon të bjerë prodhimtaria e kësaj xeheje.³⁹

Në situatën e krijuar tregtarët raguzanë nuk hoqën dorë nga tregtia me xehet e njohura të Trepçës. Përkundrazi, si është theksuar edhe më lart, në gjysmën e parë të shek. XV numri i raguzanëve, të cilët vepronin në këtë qytet, ishte shumë i madh në krahasim me shekujt e mëparshëm. Kjo dukuri shpjegohet me faktin që raguzanët, duke pasur përvojë të madhe, dinin ta shfrytëzonin si duhet çdo risi. Megjithatë, ka pasur edhe raste kur raguzanët binin në konflikt me osmanët.

Në Trepçë ndeshim shumë herët, krahas nëpunësve serbë dhe latinë, edhe nëpunës osmanë. Nga testamenti i Junii Juanni de Sorgo të përpiluar në vitin 1409, njohim se ai zotëronte katër pjesë të një pusi xeheroreje, tri pjesë i takonin pashait, vojvodë osman në këtë qytet. Osmanët themeluan edhe mahallën e vet Tripza Turcha, që, sipas M. Diniçit dhe R. Mihalçiqit, Trepça Osmane apo Trepça e Poshtme gjendej dy kilometra larg vendbanimit të vjetër, gërmadhat e të cilit quhen Stari-Tërg apo Stantërg.⁴⁰ Është për t'u theksuar se atëbotë në Trepçë, Zveçan dhe Prishtinë vepronin edhe kadilerë osmanë.⁴¹

Për raguzanët që vepronin në Trepçë situata u vështirësua edhe më gjerësisht që nga viti 1409. Atëherë Vuku, i vëllai i despotit Stefan sulmoi me ndihmën e osmanëve despotin. Në këtë rast u bë presion edhe mbi raguzanët me qëllim që të merrnin

³⁹ *Mitrovica dhe rrethina* (për periudhën mesjetare, Mihaljčić R.), Mitrovicë, 1979, fq. 60.

⁴⁰ M. Diniç, *Srpske zemlje u srednjem veku*, fq. 402; *Mitrovica dhe rrethina*, fq. 60; *Testamenta Notariae IX*, fq. 130—132.

⁴¹ K. Jireček, *Istorija Srba II*, fq. 332—333.

pjesë në këtë fushatë, gjë që bëri të reagonte qeveria raguzane, e cila dërgoi menjëherë një delegacion të përbërë nga katër bujarë raguzanë. Delegatët raguzanë i bënë me dije Vukut se qeveria e tyre nuk pajtohet me ngritjen e qytetarëve të vet kundër despotit, por tregtarët e vet i porositë që t'i mbronin vetëm ato vende, në të cilat vepronin.⁴²

Gjatë gjysmës së parë të shek. XV ndikimi osman në Kosovë rritej dita më ditë dhe kjo jo vetëm në aspektin politik, por osmanët filluan të vendosnin edhe sistemin ekonomik që lidhet drejtpërdrejt me interesat e tyre. Osmanët, duke i ruajtur vendkallimet për bregdet, pengonin edhe bartjen e xeheve të Trepçës për në Raguzë. Lidhur me lehtësimin e situatës së krijuar, Qeveria raguziane bëri ca përçarje diplomatike. Ajo dërgoi te despoti në vitin 1433 bujarët raguzanë Paladinus de Gondola dhe Andrea de Bobalio. Bujarët në fjalë nuk arritën ta realizonin me sukses misionin e paraparë, meqë despoti refuzoi të ndërhynte te sulltani.⁴³ Lidhur me keqpërdorimet që bënte përfaqësuesi i administratës osmane, sidomos për ndalimin e eksportit të argjendit, tregtarët raguzanë që vepronin në Trepçë njoftuan në fillim të marsit edhe qeverinë e vet. Sapo u informua për situatën në Trepçë, Senati Raguzan i shkroi më 6 mars 1436 despotit. Në atë letër lutet despoti që të marrë masa për pengimin e keqpërdorimeve, si dhe t'i kompensojë dëmet e bëra.⁴⁴

Ka të dhëna që flasin se administrata osmane tok me përfaqësuesit e vet »sclao turcho« plaçkitën në vitin 1436 barrët e argjendit të tregtarëve raguzanë, me motivimin se ishte i ndaluar eksportimi i argjendit, sepse i duhej punishtes osmane të prerjes së të hollave.⁴⁵ Megjithatë, raguzanët arrinin edhe më tutje ta eksportonin argjendin e Trepçës. Disa e bënë këtë fshehurazi, mirëpo të tillët e vinin veten përballë një rreziku të madh, meqë osmanët, kur i zinin, u konfiskonin të tërë mallin. Këtë e ilustron më së miri kjo e dhënë: më 8 prill 1438 kur tregtari Sayn Sugneuch nga Jeleçi i Poshtëm, si transportues i argjendit të blerë në Trepçë për raguzanët, përmes Nalko Petriçeviq u zbuloi nga osmanët se ky bartte vazhdimisht argjend, përfaqësuesit e administratës osmane ndërhyjnë dhe e plaçkitën në rrugë, ndërsa Saynin e lidhën në pranga. Kjo u bë me pretekst se sulltani, siç dihet, kishte ndaluar eksportimin e argjendit në vende të huaja me qëllim që ai të shfrytëzohej për nevojat e taraphanës së tij në Trepçë. Për këtë arsye Sayn Sugneuch ngre padi më 21. V. 1438, të cilën ia paraqiti gjykatës raguzane.⁴⁶

⁴² N. Jorga, *Notes et extraits*, II, 122; *Istorija Srpskog naroda*, II, Beograd, 1982, 81.

⁴³ I. Božić, *Dubrovnik i Turska*, Beograd, 1952, 75 — »pro franchicia argenti quod extrahitur de Sclauonia versus marinam«.

⁴⁴ K. Jireček, *Istorija Srba II*, Beograd, 1978, fq. 330—331.

⁴⁵ K. Jireček, *Istorija Srba I*, Beograd, 1978, 422; I. Božić, *Dubrovnik i Turska*, 75; S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, fq. 256.

⁴⁶ HAD, *Lamenta de foris*, fq. 31 (21. V. 1438); K. Jireček, *Istorija Srba II*, fq. 332—333.

Pas suksesit në Betejën e Dytë të Kosovës, kur, në vitin 1448, i dhanë grushta të fortë ushtrisë hungareze të udhëhequr nga Janosh Hunidi, osmanët i forcuan pozitat e veta edhe më tepër. Në kushtet e krijuara, tregtarët raguzanë filluan t'i linin vendet e rrezikuara, gjë që vërehet edhe në rënien e numrit të tyre edhe në Trepçë.⁴⁷

Trazirat e përmendura që i solli Beteja e Kosovës, nuk e ndërruan sunduesin e Trepçës dhe në këtë vend sundonte edhe më tej despoti Gjurgaj. Mirëpo, i tërë kontrolli mbi shfrytëzimin e xeheve të këtij vendi kishte kaluar gati në duart e osmanëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre që plaçkitnin pandërprerë tregtarët raguzanë. Kështu, Radiç Kuzatoviç nga »Tripza turcha« ia plaçkiti më 17. II. 1448 tridhjetë e katër funte argjend bashku dhëtarit të vet Rusko Pribisaliç. Ruskoja mbarte më vete shtatëdhjetë e pesë funte argjend, pronë e tregtarëve raguzanë Nikollë Kudelinoviç dhe Vladislav Ostojiç.⁴⁸

Në vitin 1450, tregtarët raguzanë për shkak të mospërfilljes të së drejtës raguzane (far raxon alli Ragusei) nga ana e qefaliut të Trepçës Vukosav Dobrojeviç, ranë në mosëmarrëveshje me të. Për këtë gjë, me anën e një letre të shkruar më 14 qershor, e cila arriti në Raguzë më 23 qershor, u informua edhe qeveria raguzane. Pastaj i shkruan për këtë gjë edhe despotit.⁴⁹

Trepça bie përfundimisht nën sundimin osman pas rënies së Novobërdës, në qershor të vitit 1455. Atëbotë Trepçën e ndeshim në dokumente osmane me emrin *Trepdschia*.⁵⁰

Është për t'u theksuar se edhe pas rënies së Trepçës, menjëherë në vitin e ardhshëm, përkatësisht në vitin 1456, ndeshim tregtarë raguzanë në këtë vend.⁵¹ Ndërkaq, pas disa marrëveshjeve të suksesshme raguzane me sulltanin, tregtarët raguzanë, kohë pas kohe, gjithnjë e më tepër vizitonin Trepçën dhe rrethinën.

Edhe pse Zveçani është njëri nga qytetet më të njohura mesjetare, varoshi dhe tregu i tij nuk kanë pasur ndonjë rëndësi të madhe ekonomike në mesjetë. Tregu përmendet më vonë, në dhjetëvjetshin e dytë të shek. XIV në hartën e Banjskës. Me sa dihet, këtu nuk kanë qëndruar tregtarë të huaj, pra as raguzanë. Tregu mbeti i karakterit lokal. Natyrisht, tregtarët raguzanë tregojnë interesim për koloninë xehetare të Trepçës. Afërsia e këtij vendbanimi xehetar dhe shfaqja e Mitrovicës nuk kanë ndikuar

⁴⁷ D. Kovačević—Kojić, *Dubrovačka naseobina u Smederevu u doba despotovine, Oslobodenje gradova u Srbiji od Turske 1862—1867*, SANU, Beograd, 1970, 107, 110.

⁴⁸ K. Jireček, *Istorija Srba II*, fq. 333.

⁴⁹ K. Jireček, *Istorija Srba II*, fq. 333 — Letra e qeverisë raguzane shkruar tregtarëve raguzanë në Trepçë është ruajtur vetëm në shprehje — »alli nobili e saui zentilhomini et alli mercadonti providi e discreti in Trepza«; M. Dinić, *Vlast za vreme despotovine, Zbornik Filozofski Fakultet Beograd X—1*, Beograd, 1968, 243.

⁵⁰ K. Jireček, *Istorija Srba II*, 333; Josph Von Hammer, *Historija Osmanskog carstva 1*, Zagreb, 1979, 174.

⁵¹ HAD, *Lamenta de foris XXVIII*, fq. 42.

volitshëm në zhvillimin ekonomik të Zveçanit. Gjatë mesjetës Zveçani ka qenë dhe ka mbetur pikësëpari pikëmbështetje ushtarake dhe qendër administrative.⁵²

Prej shek. XIV rëndësi të posaçme për zhvillimin e tregtisë raguzane në këtë anë, përveç Trepçës (si treg dhe xeherore), ka pasur edhe Vuçiterna. Në saje të rrethinës shumë të pasur me xehe, qyteti në fjalë ishte i njohur që nga periudha antike. Nga të dhënat që kemi mund të konstatohet se Vuçiterna në antikitet dhe më vonë, gjatë periudhës mesjetare e deri në periudhën osmane, ishte stacion i madh për tregtarë të ndryshëm.

Gjatë mesjetës Vuçiternën e ndeshim me emra të ndryshëm *Vuolcitem, Vucetarno, Vulcetarno, Vucitarnou, Vozitrin, Vlçitirna*. Ndërkaq, sipas Arnold fon Harifit, *Wolfsdorne*, dhe, sipas Andrea Bogdanit, *Vucitarone*.⁵³

Prania raguzane në Vuçiternë, sipas dokumenteve të kohës, na del më e evidente nga fundi i shek. XIV dhe fillimi i shek. XV. Atëbotë në këtë treg ndeshim një numër të shënueshëm të tregtarëve raguzanë. Madje, në pjesët jugore të despotatit, ku ekzistonte pushteti dualist, osmanët, për t'i tërhequr tregtarët raguzanë, që në vitin 1398 ulën detyrimet tatimore. Kështu, detyrimet në fjalë në Vuçiternë zbritën për 1/3. Mirëpo, sipas disa të dhënave të vitit 1411, vërehet se doganieri i Vuçiternës Obrad Milosheviqi nuk i përfillte fare risitë e vitit 1398, ai merrte ende pagesë sipas transhësë së vjetër doganore.⁵⁴

Në fillim të shek. XV në Vuçiternë ishte edhe oborri i Brankoviçëve, gjë që ndikoi për ecejake më të shpeshta afariste të raguzanëve në këtë qytet. Në këtë pikëpamje, më 2. II. 1402 Këshilli Raguzan mori vendim që zonjës Marë dhe fëmijëve të saj t'u paguante njëfarë borxhi, u vendos po ashtu që pagesa të bëhej në Vuçiternë. Nga kjo e dhënë dhe nga e dhëna e 29. XII. 1405, kur zonja Marë dhuroi dokumentin (lëshuar nga zyra e saj në Vuçiternë) lidhur me privilegjet e tregtarëve raguzanë në trojet e zotërimeve të saj, mësojmë se zonja Marë dhe fëmijët e saj, gjatë dhjetëvjetshit të parë të shek. XV vepronin kryesisht në Vuçiternë.⁵⁵ Po nga ky vit daton edhe një e dhënë interesante, nga e cila njohim se tregu i Vuçiternës tërhiqte edhe tregtarët raguzanë që vepronin në qytete të tjera kosovare. E kemi të njohur rastin e pesë raguzanëve të Prishtinës, të cilët ishin nisur me mall të vet për ditë pazari në Vuçiternë. Me të arritur në këtë qytet, ata u vendosën në një bujtinë (albergo), ku dhe e dorëzuan mallin

⁵² *Mitrovica dhe rrethina*, fq. 56 — 57.

⁵³ HAD, Në shumë libra të serialeve të ndryshme arkivore! P. Matković, *Putovanja po balkanskom poluotoku za srednega veka*, 182; K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka I*, fq. 420; *ibid*, *Istorija Srba II*, 355, Për Vuçiternën zgjerimisht shiko — E. Pllana, *Vuçiterna me rrethinë gjatë shekujve XV — XVII, Vjetar i AK, Prishtinë, 1983/XVI — XVII, 27 — 44.*

⁵⁴ M. Ivanović, *Prilozi za istoriju carina u srednjovekovnim srpskim državama, Spomenik SAN XCVII/76*, Beograd, 1984, fq. 60.

⁵⁵ K. Kostić, *Naši gradovi na jugu*, Beograd, 1922, fq. 55.

për ta ruajtur. Mirëpo, rreth ruajtjes së mallit lindi një mosmarrëveshje. Të nesërmen, ndërkaq, për shkak të motit të lig, malli i tyre mbeti pa u shitur.⁵⁶

Lidhjet e afërta të Raguzës me zotërimet e Brankoviçëve vërehen edhe nga fakti, që qeveria raguzane në vitin 1411 u rekomandoi tregtarëve të vet që të shkonin në Vuçiternë te zonja Marë.⁵⁷

Për praninë e raguzanëve në Vuçiternë gjatë gjysmës së parë të shek. XV ndeshim edhe të dhëna të tjera, si, bie fjala, në vitin 1441, kur qyteti në fjalë kishte rënë përkohësisht nën sundimin osman dhe Shabadin pashai, sanxhakbe i »pjesëve perëndimore«, u shkroi tregtarëve raguzanë që vepronin në Vuçiternë.⁵⁸

* K. Jireček, *Zbornik K. Jirečeka I*, fq. 419 — 420 — »... Tu say, come nuy tornadose de Pristina tu me zonzesti in hoschi de Chossoua, et cum nuy era ply nostri Ragusini. Vignando in Vozitrin fossemo in un albergo tuti, çoche çaschuono de nuy del suo valixio recomando al stanani. Come recomando, chussi tolse!«.

⁵⁷ K. Kostić, *Naši gradovi na jugu*, fq. 55.

* K. Kostić, *Naši gradovi na jugu*. fq. 55.

LEGJENDE

Faksimil i testamentit të bujarit raguzan me origjinë shqiptare Junius Juan de Sorgo, i cili vdiq në Trepçë më 21 tetor 1409. Testamenti u përpilua më 9 shtator 1409. Junius de Sorgo është njëri nga shumë bujarët raguzanë të cilët vepruan në Trepçë. Është për t'u theksuar se pjesëtarët e familjes Sorgo shumë shpesh zihen ngoje në Trepçë. Ata përveç aktivitetit tregtar, shpesh i ndeshin në postin e konsullit raguzan në Trepçë. Po ashtu, roli i tyre ishte i dukshëm në jetën diplomatike. Duke lënë testamentin e shkruar në 5 faqe, që ruhet në serialin Testamenta Notariae të Arkivit Historik të Dubrovnikut (HAD), libri IX, f. 130^v—132^v, Junius de Sorgo, tani si burim historik i dorës së parë për historinë kosovare dhe më gjerë, fiton zulumën e një personaliteti historik. Vlera e testamentit të Junius Juan de Sorgos qëndron në faktin se përmbajtja e tij jep të dhëna të mjaftueshme për pasurinë e tij të patundshme në Trepçë. Po ashtu, në testamentin e tij ndeshim hollësi mjaft interesante mbi organizimin dhe pasuritë xehetare të xehereve të Trepçës.

Dr. Jahja Drançolli

LES RAGUSIEN A TREPÇA. ET DANS LES VILLES ENVIRONNATES DURANT LES XIV—XV SIECLES

R é s u m é

Duran l'époque du féodalisme développé, Trepça était un centre important sur le territoire de la Kosova actuelle. Il y avait d'importantes richesses naturelles, à savoir du plomb et de l'argent. C'est la raison pour laquelle Trepça attirait très tôt l'attention des commerçants, de ceux venant de la côte adriatique et tout particulièrement de Dubrovnik, de Kotor, de Venise, de Split, de Bar, de Shkodra etc. La présence et l'intérêt des commerçants venant des villes mentionnés ci-dessus pour les richesses minières de Trepça, conditionnèrent au XIV^e siècle une grande concurrente commerciale. Ainsi, Trepça devint-elle un centre commercial très important. Dans la première moitié du XV^e siècle Trepça devint une colonie commerciale très importante de Dubrovnik. Selon les données des différends judiciaires qui ont eu lieu à Trepça dans les années 1412, on peut se rendre compte que Trepça était à cette époque la plus importante colonie ragusienne dans les Balkans.

Il est à remarquer que Trepça et Janjeva étaient plus fréquentées par des Ragusiens citadins que par des représentants du particiat ragusien. A partir d'une abondante documentation des Archives d'Histoire de Dubrovnik, et surtout à partir des livres des séries Reformations et Acta Consilii Minoris, on rencontre à Trepça le plus souvent les représentants de la famille patricienne De Sorgo. Le nombre des Ragusiens à Trepça, dans la première moitié du XV^e siècle varie selon les rapports des Ragusiens avec le despote serbe, avec les souverains locaux et les incursions des Turcs.